



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

## OPINION MBI RAPORTIN VJETOR TË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURISË DHE KONFLIKTIT TË INTERESIT PËR VITIN 2021

Pasi u njohëm me Raportin e mësipërm që i është dërguar Kuvendit të Shqipërisë, parashtrijmë mendimet e mëposhtme:

Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) me të drejtë i referohet Rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë të parashikuara në Rezolutën e tij për vitin 2021. Në Raport paraqitet numri i kërkesave që i janë dërguar atij nga institucionet përkatëse të qeverisjes së sistemit të Drejtësisë.

✚ Përsa i përket zbatimit të Ligjit Nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” i ndryshuar (shih faqe 9 të Raportit), KShH vëren se në Rezolutën e Kuvendit thuhet se njësitë përgjegjëse nuk kanë paraqitur raporte vjetore siç parashikojnë nenet 13 dhe 22 të Ligjit 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Po në këtë rezolutë trajtohet gjithashtu edhe mbrojtja nga hakmarrja, etj.

KShH mendon se megjithëse nga miratimi i ligjit nr.60/2016 ka kanë kaluar afro 6 vjet, zbatimi i tij në praktikë lë mjaft për të dëshiruar. Do të ishte mirë që në raportin e ILDKPKI-së të evidentoheshin shkaqet që kanë sjellë nivelet e ulëta të zbatimit të tij, sfidat me të cilat përballlet vetë ILDKPKI, por edhe funksionarët pjesë e Njësive Përgjegjëse për sinjalizimin, si dhe “mësimet” e nxjerra (*lessons learned*) në kuadër të zbatimit të këtij legjislacioni, kundrejt përmirësimit të mëtejshëm të masave që duhet të ndërmerren për efikasitetin e zbatueshmërisë.

Në paragrafin 4 të faqes 10 të Raportit thuhet se ndaj 48 organizatave që nuk kishin ngritur njësitë përgjegjëse janë zbatuar gjopa administrative. Mirë do të ishte të përmendeshin organizatat e ndëshkuara, si dhe shkaqet përse nuk janë ngritur ato.

✚ Në faqen 11 të Raportit, paragrafi III bëhet fjalë për kontrollin e 192 njësive përgjegjëse në sektorin publik në përputhje me kërkesat e Vendimit të K.M. N 818 datë 16.11.2016 por nuk thuhet çfarë rezultoi nga ky kontroll. Në Raport mund të përmendeshin paraqitëshin raportet vjetore të dërguara nga Njësitë përgjegjëse (është fjala për arritjet, mungesat apo vështirësitë) sepse evidentimi i tyre do të mundësonte marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes.

✚ Në Raport (shih faqen 12) thuhet se Inspektoriati i Lartë ka marrë dhe ka administruar 199 raporte vjetore nga njësitë përgjegjëse pranë autoriteteve publike ku konstatohet se në 3 njësi janë sinjalizuar dhe trajtuar raste në kuadër të Ligjit 60/2016 dhe më poshtë përmendet: Banka e Shqipërisë, Bashkia Tiranë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Në Bankën e Shqipërisë është tërhequr sinjalizimi. Në Bashkinë e Tiranës janë regjistruar 6 raste sinjalizimi dhe janë kryer veprime procedurale, por për rezultatin dhe impaktin e këtyre sinjalizimeve nuk thuhet gjë. Ky konstatim i KShH-së është i përsëritur referuar rekomandimeve që kemi dhënë edhe për raportet e viteve të kaluara. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve janë sinjalizuar dy raste. Tërheq vëmendjen fakti se në 199 raportet vjetore të njësive të autoriteteve publike, numri i sinjalizimeve është i papërfillshëm (8 raste). Gjithashtu, dëshirojmë të sjellim në vëmendje, se nga monitorimi i



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

detajuar që KShH ka realizuar mbi praktikën dokumentative të anonimizuar dhe procedurën e ndjekur në kuadër të shqyrtimit të sinjalizimit nga strukturat e brendshme përgjegjëse pranë Bashkisë Tiranë, ka rezultuar se procedura e hetimit administrativ në rastin në fjalë nga NjP e Bashkisë Tiranë, bie ndesh me nenet 43, pika 4, dhe 90 të Kodit të Procedurave Administrative (KPA), nenit 14 pika 3 të ligjit nr. 60/2016 dhe nenit 7 të Rregullores “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në institucionin e Bashkisë Tiranë” miratuar nëpërmjet Urdhërit nr. 7622, dt. 21.02.2018 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë.<sup>1</sup>

✚ Në sektorin privat sipas raportit janë ngritur 527 njësi përgjegjëse (shih faqen 12) dhe janë administruar 321 raporte sinjalizimi, por nuk është raportuar asnjë rast sinjalizimi. Qoftë edhe vetëm ky fakt mendojmë se bënte të nevojshme që në raport të përmendeshin cilat ishin shkaqet e kësaj gjendje, siç mund të ishin p.sh. mosnjohje e ligjit nga punonjësit ose moszbatimi i procedurave të hetimit administrative nga njësitë përgjegjëse, etj.

✚ Në faqe 15 të Raportit bëhet fjalë edhe për referime penale. Mendojmë se do të kishte interes të thuhej sa referime (denoncime) penale ishin bërë dhe si kishin përfunduar ato. A kishte filluar çështja penale apo ishte pushuar dhe a kishte ndonjë rast që vendimi i prokurorisë apo gjykatës të ishte ankuar. A ka patur raste që Inspektoriati të ketë denoncuar në prokurori gjyqarë apo prokurorë që i ishin nënshtruar procesit të rivlerësimit.

✚ Sipas Raportit për periudhën 2014-2021, Inspektoriati i Lartë ka referuar pranë institucionit të Prokurorisë, hetimit tatimor, etj.... 518 subjekte. Mirë do të ishte që në Raport, sidomos për referimet (denoncimet) në Prokurori të përmendej se si të kishin përfunduar ato, nëse kishte filluar hetimit dhe dërguar në gjyq, nëse nuk ishte filluar hetim apo pushuar çështja. Në këto dy rastet e fundit, prokuroria ose gjykata në përputhje me Kodin e Procedurës Penale duhet të njoftonin denoncuesin (Inspektoriatin e Lartë) dhe ai kishte të drejtën e ankimit.

Në funksion të shqyrtimit të këtij raporti të ILDKPKI-së, vlen të evidentohet se KShH ka publikuar në Shkurt të vitit 2021, “Sinjalizimi i korrupsionit në bashki: Sfidat dhe vështirësitë e zbatimit të legjislacionit në 10 Bashkitë e vendit”. Ky monitorim është realizuar duke marrë në konsideratë të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe standartet ndërkombëtare (duke marrë për referencë Direktivën e BE-së). Metodologjia e monitorimit të KShH-së është konceptuar duke kërkuar akses në disa të dhëna të natyrës cilësore dhe sasiore të disponuara nga ILDKPKI dhe 10 Bashkitë, bazuar në garancitë e parashikuara në

<sup>1</sup> Lidhur me këtë rast, KShH u njoh me përgjigjen e përcjellë nga ana e NjP-së të Bashkisë Tiranë, me shkresën nr.prot. 22348/2, dt. 23.12.2020, ku informohemi se: “Përsa i përket sinjalizimit që është depozituar pranë Njësisë Përgjegjëse në Bashkinë Tiranë, ju bëjmë me dije se është shqyrtuar nga ana jonë brenda afateve ligjore dhe është vendosur për mosfillim dhe përfundim të hetimit administrative për arsye se sinjalizuesi ka qenë në kushtet e mirëbesimit, të përcaktuara në nenin 6, të ligjit nr. 60/2016, por nuk ka patur vendimmarrje konkrete në lidhje me këtë rast”. KShH vlerëson se kjo vendimmarrje ka mangësi procedurale ligjore, për shkak se në këtë rast se është vendosur mosfillimi dhe përfundimi i hetimit administrativ, por nuk është realizuar referimi ligjor në dispozitën 14, pika 2, gërma b) të ligjit nr. 60/2016.

Link akses i Raportit të Monitorimit, të publikuar nga KSHH: [https://ahc.org.al/ep-content/uploads/2021/03/3.3.21\\_Final\\_KORRUPSIONI2021\\_shqip.pdf](https://ahc.org.al/ep-content/uploads/2021/03/3.3.21_Final_KORRUPSIONI2021_shqip.pdf)



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

KShH vërejtë se një pjesë e të dhënave të vëna në dispozicion nga Bashkitë e monitoruara reflekton edhe situatën e viteve të mëparshme, që prej miratimit të ligjit në Qershor 2016. Raporti i plotë i monitorimit mund të aksesohet në këtë link:

[https://ahc.org.al/ep-content/uploads/2021/03/3.3.21\\_Final\\_KORRUPSIONI2021\\_shqip.pdf](https://ahc.org.al/ep-content/uploads/2021/03/3.3.21_Final_KORRUPSIONI2021_shqip.pdf)

KShH vlerëson maksimalisht adresimin e disa prej rekomandimeve të mëparshme të realizuara me të njëjtin qëllim, nga institucionet përgjegjëse që kanë rezultuar nga një vlerësim i gjerë dhe konkret që KShH ka realizuar gjatë dy viteve të fundit. Rekomandime e adresuara për ILDKPKI-në që mund ti nënshtrohen diskutimit gjatë debatit parlamentar në shqyrtimin e raportit vjetor të ILDKPKI-së, janë si vijon:

- ✚ KShH i rekomandon ILDKPKI-së të krijojë instrumenta të qëndrueshëm në veprimtarinë e saj që mundësojnë fuqizimin e rolit pro-aktiv në drejtim të mbikqyrjes sistematike ndaj Njësive Përgjegjëse që janë ngritur pranë organeve publike dhe enteve private, me qëllim zbatimin me efektivitet të ligjit 60/2016.
- ✚ Rekomandojmë rritjen e mëtejshme të angazhimit të ILDKPKI-së në udhëzimin e Njësive Përgjegjëse për formën dhe të dhënat e nevojshme që duhen paraqitur në raportin vjetor, nevojën për respektimin e afateve ligjore, etj, me qëllim orientimin drejt një raportimi në mënyrë cilësore dhe me standart të unifikuar, duke mundësuar në këtë mënyrë edhe vlerësimin për impaktin konkret të zbatimit të ligjit, sfidat dhe mangësitë që paraqiten.
- ✚ KShH inkurajon ILDKPKI-në që në bashkëpunim me Njësitë Përgjegjëse të Bashkive, të forcojnë angazhimin për ndërgjegjësimin dhe njohjen e një numri më të gjerë punonjësish lidhur me ligjin nr. 60/2016 (nëpërmjet sesioneve informuese, trajnimeve, takimeve online etj). Në këtë drejtim, KShH inkurajon më tej ILDKPKI-në që të krijojë mekanizma sa më të qëndrueshëm që nuk fokusojnë këtë proces vetëm në kuadër të projekteve sporadike (apo të kufizuara/fragmentarizuara në kohë) si dhe të vijojë në të njëjtën frymë bashkëpunimin me aktorë të shoqërisë civile, për sa i takon ndërgjegjësimin dhe monitorimit të këtij ligji.